



Shoqata „Gruaja ne INTEGRIM“ – Shkoder

STATUTI I SHOQATES

Rregullat e zakonshme te aktivitetit te shoqates.

Themelimi , Emertimi

Neni nr 1

Shoqata „Gruaja ne INTEGRIM“ eshte themeluar me deshiren e lire te nje grupi intelektual ne Shkoder, me qellim adresimin e ceshtjeve gjinore, sociale, ekonomike, mjedisore, kulturore dhe ligjore te grupeve te caktuara te shoqerise ne pergjithsi dhe ato gjinore ne vecanti.

Neni nr 2

Shoqata „Gruaja ne INTEGRIM,, eshte organizate jo qeveritare dhe jo politike, jo-fitim pruresse me qellime te caktuara per zhvillimin e qendrueshem te shoqerise, edukimin dhe rritjen e kapaciteteve te aktoreve vendore, kombetare e me gjere. Aktivitetin e kesaj organizata e zbaton ne perputhje te plote me ligjin per funksionimin e organizatave te shoqerise civile, kushtetuten e Shqiperise dhe normat e parimet e shoqerise sone.

Neni nr 3

Shoqata „Gruaja ne INTEGRIM,, eshte subjekt juridik dhe zoteron simbolin dhe vulen e saj. Ajo e merr kete te drejte duke filluar qe ditën e rregjistrimit te saj ligjor ne Gjykatën e Rrethit Gjyqsor Shkoder.

Organizata e shtrin aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Shqiperise dhe jashte saj ne partneritet me organizata nderkombetare apo rajonale. Qellimi i organizates eshte integrimi i shoqerise ne proceset e zhvillimit te shoqerise demokratike dhe ne perputhje me normat e reja te shoqerise se sotme Evropjane.

Neni nr 4

Misionin e saj Shoqata „Gruaja ne INTEGRIM” e permbush përmes bashkepunimit me OJFt, institucionet në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal, si dhe të aktorëve të ndryshëm që veprojnë në fushën e zhillimit te qendrueshem dhe ceshtjeve gjinore. Gjithashtu, GI nxit pjesëmarrjen publike dhe shkëmbimin e lire te informacionit. Organizata e zhvillon aktivitetin e saj ne bashkepunim me organizata dhe institucione te tjera, ne menyre qe te kete mundesi permiresimi te vazhdueshem si ne ide ashtu dhe ne programe qe cilat synojne zhvillimin e qendrueshem te shoqerise.

Neni nr 5

Shoqata nuk ka ndonje afat te percaktuar te jetegjatesise se saje, ajo mund te shperndahet vetem kur organi drejtues i saj (komiteti drejtues) ne mbledhjen e saj, vendos per shkrirjen e shoqates. Komiteti drejtues eshte legjitim per zgjedhjen e drejtuesit ekzekutivte shoqates dhe aprovon ndryshimet e mundsheme ne bordin mbikqyres.

Neni nr 6

Organi kryesor mbikqyres i organizates eshte Asambleja e Anetareve, qe mblidhet nje here ne dy vjet. Asambleja e Anetareve ka ne perberje 9 perfaqesues dhe ka keto detyra kryesore: analiza e punes dy

vjeçare te organizates, permiresimi dhe aprovimi i programeve te punes, ndryshimet e mundeshme ne statut ne lidhje me fushat prioritare dhe tematikat e trajtuara nga organizata ne dy vite.

Neni nr 7

Komiteti drejtues, nen mbikqyrjen e drejtuesit ekzekutiv te shoqates drejton aktivitetin te shtrire ne periudha dy vjeçare. Aktiviteti i komitetit drejtues duhet te jete ne perputhje te plote me programin e organizates dhe statusin e perkrahur dhe miratuar nga komiteti mbikqyres i organizates.

Neni nr 8

Asambleja e Anetareve ka te drejten e vendimit vetem gjate takimit te tij, kur ne takim marrin pjese me shume se 2/3 e bordit drejtues dhe nga me shume se 50% e anetareve te pergjitheshem te shoqates.

Neni nr 9

Çdo vendim per aktivitet, shqyrtohet dhe aprovohet fillimisht nga bordi drejtues dhe drejtuesi egzekutiv i shoqates, pastaj mund te procedohet me hapat e tjere per zhvillimin dhe organizimin e veprimtarive te ndryshme.

Neni nr 10

Çdo veprimtari duhet te jete ne perputhje me programin e shoqates me nje levizje jo me te madhe se 20 % kur eshte fjala per propozime te reja te cilat duhet te gjejne perkrahje nga Asambleja e Anetareve qe jane prezent me mbi 50 % + 1 te tyre. Asnje anetare i bordit drejtues apo i shoqates nuk mund te abuzojne mbi programin e shoqates pa marre miratimin e drejtorit egzekutiv te shoqates.

Neni nr 11

Per te balancuar te drejtat e te dy paleve, Asamblese dhe Bordit eshte nje rol ndares qe ka qellimin te pjeseve te barabarta. E drejta e votimit te trupit te eproreve eshte e kufizuar ne zgjedhjen e presidentit dhe te anetareve te bordit drejtues. E drejta e votimit te anetareve te organizates eshte e kufizuar te aprovoje ose jo propozime per te ndryshuar programin dhe statutin e organizates, dhe per te ndryshuar strukturen e bordit drejtus.

Neni nr 12

Anetaresimi

Anetaresimi eshte i lejuar vetem per ato persona qe kane moshen 18 vjec e siper, dhe qe jane te motivuar te punojne ne programin/projektet e shoqates. Kerkesa per anetaresim behet me shkrim e shoqeruar me CV perkatese te personit dhe i drejtohet komitetit drejtues te shoqates i cili ben miratimin ne perputhje te plote me rregullat e anetaresimit.

Jane anetare te shoqates te gjithe nenshkruesit e aktit te themelimit te saj, qe kane pranuar statutin, misionin, dhe marrin pjese ne takimet e organizates pa shkelur interesat e saj legjitime.

Kuota e rregjistrimit te anetareve eshte 500 ndersa kuotizacioni vjetor eshte 1200 leke. Çdo anetare mund te largohet nga shoqata me me kerkesen e vet.

Neni 13

TE DREJTAT E ANETAREVE

- ❖ Te zgjedhin organet drejtuese te shoqates
- ❖ Te zgjidhen nga organet drejtuese te shoqates
- ❖ Te perfitojne nga sherbimet qe i afrohen shoqates
- ❖ Te kerkojne llogari per shpenzimet qe kryhen nga shoqata
- ❖ Te apelojne kunder vendimeve te komitetit drejtues, kur keto te fundit i shohin te pa drejta.

Neni 14**DETYRIMET E ANETAREVE TE SHOQATES**

- ❖ Te marrin pjese ne veprimtarite e shoqates
- ❖ Te respektojne statutin ,rregulloren e brendeshme dhe vendimet e organeve drejtuese te shoqates .
- ❖ Te paguajne shumen e caktuar per rregjistrim dhe kuatizacionin vjetor
- ❖ Te sjelle informacionet e mundeshme per shoqaten
- ❖ Te kompensoje çdo dem te shkaktuar ne drejtim te shoqates.

Neni 15**Burimet Financiare**

Fondi i shoqates perbehet nga:

- ❖ Detyrimet vjetore te paguara nga anetaret;
- ❖ Kontributet e paguara prej anetareve te rinj ne perputhje me dispozitat e statutit;
- ❖ Parate e dhena dhurate, hua, subvensione, grante, apo sherbime konsulence per institucione dhe qeveritare dhe jo qeveritare.

Fondi i shoqates eshte i depozituar prane Bakes se Kursimeve ne Shkoder.

Terheqja e parave nga banka behet vetem me firmen e drejtuesit te shoqates dhe/ose te autorizuesit nga ana e drejtuesit firmat e te cileve jane te depozituara prane llogarise bankare te kesaj shoqate.

Neni 16

Shoqata pushon aktivitetin e saj me vendim te organit qe e ka miratuar.

Kur provohen shkelje te dispozitave ligjre ne fuqi ne Republiken e Shqiperise dhe per rastet e parashikuara ne nenin 52 te kodit civil.

Neni 17

Takime te jashte rradhe e komitetit drejtues zhvillohet ne momentin qe mund te kete ngarje te tilla si:

- ❖ Ndryshime ne stafin e komitetit te drejtuesve, ndryshime ne program dhe strukture.
- ❖ Ankesa per anetaret e perjashtuar ne vendimet arbitrare te keshillit drejtues.

Neni nr 18

Komiteti drejtues perbehet nga:

- Drejtuesi i Shoqates – Drejtor Ekzekutiv
- Koordinatori i shoqates – Drejtor Teknik
- Menaxher Projekti – Ekspert Tematik
- Menaxher Projekti – Ekspert Tematik
- Asistent Projekti
- Konsulent Financiar
- Sekretar/asistent zyre

Neni nr 19

Drejtues i shoqates mund te behet çdo anetar i shoqates i cili ka plotesuar rregullisht detyrimet e tij financiare per nje periudhe prej 24 muajsh; ka hartuar projekte dhe siguruar fonde per shoqaten, ka implementuar projekte dhe ka network te qendrueshem me autoritetet vendore, institucionet, Organizatat e Shoqerise Civile.

Neni nr 21

Themeluesit e organizates jane te shpallur automatikisht primar per marrjen e pozicionit te drejtuesit.

Neni nr 22

Shpallja e Drejtuesit eshte kryer nga anetaret e Komitetit drejtues ne asamblene e anetareve. Si rrjedhoje i shpalljes Kryetare, anetari fiton te drejten e plote per udheheqjen e shoqates **“Gruaja ne INTEGRIM”**

Neni nr 23

E drejta e te qenit anetar eshte humbur ne momentin qe anetari braktis organizaten ose eshte perjashtuar nga vendimi i drejtorit te bordit (keshillit drejtues).

Neni nr 24

Organizata ruan te drejten per te krijuar deget e saj te veta kudo ne Shqiperi dhe jashte saj kur ajo gjen mbeshtetes dhe financim.

Per shoqaten “Gruaja ne Integrim”

Atrida Ferketi
Program Manager